



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E TIRANËS
QENDRA EKONOMIKE E ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____. _____. 2019

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Data 22.08.2019

**Për: Operatorin Ekonomik “Malbertex” Sh.p.k, me adresë kryesore, Siri Kodra
Bl.Magazinave, Tiranë.**

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **Blerje materiale të buta dhe dyshekë për fëmijë. REF-20011-04-30-2019.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Blerje materiale të buta dhe dyshekë për fëmijë.**

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Çarçaf shtrati i poshtëm (basme)	Copë	1500
2	Çarçaf shtrati i sipërm (basme)	Copë	1500
3	Këllëf jasteku (basme)	Copë	1500
4	Çarçaf shtrati i poshtëm (fanellate)	Copë	4500
5	Çarçaf shtrati i sipërm (fanellate)	Copë	4500
6	Këllëf jasteku (fanellate)	Copë	4500
7	Dyshekë krevati për fëmijë	Copë	3000

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin do të jetë nga data e nënshkrimit të kontratës me përfundim më 31/12/2019.

Publikime të mëparshme : Buletini i Njoftimeve Publike Numër 18, datë 06 Maj 2019.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomike më e favorshme

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **“AN&RA” Sh.p.k**

K12205001I

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera e ofruar është 19, 635, 000 (nëntëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë pa T.V.SH.

2. **“Atlantik 3” Sh.p.k**

K22218003V

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera e ofruar është 0 lekë pa T.V.SH.

3. **“Euro 2001” Sh.p.k**

K13112202Q

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera e ofruar është 20, 865, 000 (njëzetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë pa T.V.SH.

4. **“Shaga” Sh.p.k**

J96822229J

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera e ofruar është 18, 000,000 (tetëmbëdhjetë milion) lekë pa T.V.SH.

5. **“Malbertex” Sh.p.k**

K71821009N

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera e ofruar është 19, 770, 000 (nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa T.V.SH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **“AN&RA” Sh.p.k**

K12205001I

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. **“Atlantik 3” Sh.p.k**

K22218003V

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

3. “Euro 2001” Sh.p.k

K13112202Q

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

4. “Shaga” Sh.p.k

J96822229J

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. “AN & RA” Sh.p.k

1.1 Kriteret e veçanta pika 2.3.7, operatori ekonomik nuk e përmbush plotësimin e këtij kriteri. Operatori duhet të paraqiste për subjektin “4 Vëllezërit” me të cilin do të realizonte furnizimin me çarçafë, dokumentacionin i cili të vërtetonte ligjshmërinë e veprimtarisë së këtij subjekti për mallrat objekt i këtij prokurimi dhe jo vetëm autorizim për paraqitje oferte.

1.2 Kriteret e veçanta pika 2.3.9, 2.3.10 operatori ekonomik nuk ka dorëzuar mostrat sipas specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor për artikujt e kërkuar:

1.2.1 Artikulli “dyshek krevati për fëmijë”

- Është konstatuar se mbi dyshekun e paraqitur si mostër nuk ka asgjë të shënuar, stampim apo etiketim (me qepje) nga prodhuesi, ku të vërtetohet se ky dyshek është prodhim i prodhuesit “DEA” shpk.

- Për artikullin e paraqitur si mostër, OE nuk ka paraqitur “Skedën teknike” (orgjinale apo fotokopje të noterizuar) sikurse kërkohet në dokumentat e tenderit, duke deklaruar se e ka paraqitur atë në sistemin elektronik.

- Nga ana e KVO, komisionit për verifikimin, inspektimin dhe marrjen në dorëzim të mostrave i është vënë në dispozicion “Skeda teknike” e prodhuesit, e paraqitur në sistemin elektronik nga OE.

- Komisioni për verifikimin, inspektimin dhe marrjen në dorëzim të mostrave, konstaton se “Skeda teknike” e paraqitur është lëshuar nga prodhuesi “Dea” shpk.

- Në skedën teknike të paraqitur janë përshkruar: Përmasat e shtresave të dyshekut dhe parametrat e copës së përdorur.

- Për arsye se dysheku i paraqitur si mostër nuk ka asnjë shenjë dalluese që të vërtetojë se është produkt i prodhuesit “Dea” shpk, skeda teknike e paraqitur nuk mund të merret në konsideratë nga komisioni për verifikimin, inspektimin dhe marrjen në dorëzim të mostrave.

- Për artikullin e paraqitur si mostër, OE ka paraqitur një Katalog (në origjinal) të prodhuesit të dyshekëve “Dea sleep”. Në këtë katalog paraqiten një seri fotosh dyshekësh krevati me emërtime të ndryshme (Fiora, Elegant, Confort, Brillant, Rubin, Elasso, Prestige, Smerald, Hamburg, Bremen, Vip, Imperial, Geneva, Magic, Vanity dhe Majesty), por asnjëri nga dyshekët e katalogut nuk

përputhet me të dhënat e dyshekut të kërkuar dhe dyshekun e paraqitur si mostër.

- Nuk ka asnjë shenjë dalluese që të vërtetojë se mostra e paraqitur ka lidhje me katalogun e paraqitur.

- Për këtë arsye katalogu i paraqitur nuk mund të merret në konsideratë nga komisioni për verifikimin, inspektimin dhe marrjen në dorëzim të mostrave.

Për “Materialin veshës të dyshekut”, OE nuk ka paraqitur “*Dokumentin e miratimit nga institucione të akredituara dhe të jetë e certifikuar OEKO-TEX “Lista e Bardhe” Standard 100 per bebe ose ekuivalente me të*”. (orgjinale apo fotokopje të noterizuar) sikurse kërkohet në dokumentat e tenderit, duke deklaruar se e ka paraqitur atë në sistemin elektronik.

Nga ana e KVO, komisionit për verifikimin, inspektimin dhe marrjen në dorëzim të mostrave, i është vënë në dispozicion Çertifikata “OEKO-TEX STANDARD 100”, e prodhuesit “Dea” shpk, me nr. 1807066, e lëshuar nga “Centexbel” Technologiepak7, Belgjikë, e vlefshme deri më 31.07.2019, e paraqitur në sistemin elektronik nga OE, “AN&RA” shpk.

Për arsye se dysheku i paraqitur si mostër nuk ka asnjë shenjë dalluese që të vërtetojë se është produkt i prodhuesit “Dea” shpk, Çertifikata “OEKO-TEX STANDARD 100”, e prodhuesit “Dea” shpk, e paraqitur nuk mund të merret në konsideratë nga komisioni për verifikimin, inspektimin dhe marrjen në dorëzim të mostrave.

Për “Materialin veshës të dyshekut”, OE nuk ka paraqitur “Deklaratë konformitetit të prodhuesit dhe /ose prodhuesve të lëndës së parë” duke deklaruar se i ka paraqitur ato në sistemin elektronik.

Pas verifikimit në sistemin elektronik, nga ana e KVO konstatohet se OE nuk ka paraqitur “Deklaratë konformiteti”.

Për “Strukturën e brendshme të dyshekut”, OE nuk ka paraqitur “Deklaratë konformitetit të prodhuesit dhe /ose prodhuesve të lëndës së parë” duke deklaruar se i ka paraqitur ato në sistemin elektronik.

Pas verifikimit në sistemin elektronik, nga ana e KVO konstatohet se OE nuk ka paraqitur “Deklaratë konformiteti”.

Për “Këllëfin e jashtëm të dyshekut””, OE nuk ka paraqitur “Deklaratë konformitetit të prodhuesit dhe /ose prodhuesve të lëndës së parë” duke deklaruar se i ka paraqitur ato në sistemin elektronik.

Pas verifikimit në sistemin elektronik, nga ana e KVO konstatohet se OE nuk ka paraqitur “Deklaratë konformiteti”.

Duke analizuar të dhënat e mostrës së paraqitur dhe dokumentacionin shoqërues të kërkuar nga AK, mostra e paraqitur nuk i plotëson specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Oferta ekonomike 19, 635, 000 lekë pa tvsh.

2. “Atlantik 3” shpk

2.1 Operatori ekonomik ka paraqitur në sistem vetëm vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike.

Oferta ekonomike: 0 lekë pa tvsh.

3. “Euro 2001” shpk

3.1 Kriteret e veçanta pika 2.3.5, operatori ekonomik ka paraqitur një kontratë qeraje e cila është jashtë afateve ligjore, ka përfunduar që në 2015.

3.2 Kriteret e veçanta pika 2.3.7, operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në përmbushje të këtij kriteri.

3.3 Kriteret e veçanta pika 2.3.8, operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në përmbushje të këtij kriteri.

3.4 Kriteret e veçanta pika 2.3.9, operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në përmbushje të këtij kriteri.

3.5 Kriteret e veçanta pika 2.3.10, operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostra në ditën dhe orën e hapjes së ofertave.

Oferta ekonomike: 20, 865, 000 lek pa tvsh.

4. “Shaga” shpk

4.1 Kriteret e veçanta pika 2.1.1 , operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2016.

4.2 Kriteret e veçanta pika 2.3.1 , operatori ekonomik nuk ka paraqitur kontrata të ngjashme për mallrat objekt i këtij prokurimi. Ka paraqitur një kontratë furnizimi për mobilje dhe orendi.

4.3 Kriteret e veçanta pika 2.3.5 , operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për disponimin e një magazine jo më pak se 100 m2. Certifikata e paraqitur i përket një trualli.

4.4 Kriteret e veçanta pika 2.3.7 , operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për posedimin e autorizimit me prodhuesin për mallrat objekt i këtij prokurimi.

4.5 Kriteret e veçanta pika 2.3.8, operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në përmbushje të këtij kriteri.

4.6 Kriteret e veçanta pika 2.3.9, operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në përmbushje të këtij kriteri.

4.7 Kriteret e veçanta pika 2.3.10, operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostra në ditën dhe orën e hapjes së ofertave.

Oferta ekonomike: 18, 000, 000 lekë pa tvsh.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik **“Malbertex”** Sh.p.k, me adresë kryesore Rruga **Siri Kodra, Bll.Magazinave, Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **19, 770, 000 (nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa T.V.SH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqesni pranë Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, me adresë Rr. “Barrikadave”, Çerdhja Nr. 1, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar), siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 11.06.2019.

Ankesa: Ka patur ankesë nga ana e Operatorit Ekonomik **“AN&RA”** Sh.p.k dhe ka marrë përgjigje në datë 19.06.2019 nga ana e AK QEZHEF.

Operatori Ekonomik **“AN&RA”** Sh.p.k, në vijim ka depozituar ankesë pranë KPP-së.

Me vendimin Nr. 549/2019 datë 19.08.2019, KPP ka vendosur të mos pranoj ankesën e OE **“AN&RA” sh.p.k** dhe te lejoj AK QEZHEF, të vijoj me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Zhaneta Beqiri